



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

RAPORT MONITORIMI

JANAR – DHJETOR 2023

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

TABELA E PËRMBAJTJES

- I. Hyrje
- II. Raporti i monitorimit të buxhetit të DPAP-së Janar - Dhjetor 2023
- III. Analiza e realizimit të buxhetit të DPAP-së Janar - Dhjetor 2023
- IV. Të dhëna të përgjithshme

Aneksset bashkëlidhur:

- Aneksi nr. 1 Raporti përmbledhës i shpenzimeve të institucionit buxhetor
- Aneksi nr. 1.1 Raporti i shpenzimeve të institucionit buxhetor sipas kapitujve
- Aneksi nr.1.2 Shpenzimet buxhetore nw total programi dhe institucioni buxhetor
- Aneksi nr. 2 Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit në nivelin e Programit të Buxhetit"
- Aneksi nr.2.1 Shpenzimet e programit sipas kapitujve
- Aneksi nr. 3 Raporti i performancës së produkteve të programit
- Aneksi nr. 3.1 Raporti i performancës së produkteve të programit sipas artikujve
- Aneksi nr. 3.2 Deviacioni kostos për njësi në vite
- Aneksi nr. 4. Raporti i realizimit të treguesve të performances së programit

HYRJE

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP), është tërësia e institucioneve administrative dhe ofruese të shërbimeve arsimore parauniversitare, pjesë integrale e sistemit të ministrisë përgjegjëse për arsimin, që kontribuon në realizimin e qëllimit të përgjithshëm për të siguruar shërbim arsimor cilësor.

DPAP-ja ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në:


- **nivel qëndror**, nëpërmjet drejtorisë qendrore-DPAP.
- **nivel rajonal**, nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar-DRAP.
- njësitë e ofrimit direkt të shërbimeve, të cilat përfshijnë **zyrat vendore të arsimit parauniversitar ZVAP**.
- **institucionet arsimore** të sistemit parauniversitar publik, shkollat.

Misioni i DPAP-së.

Misioni i DPAP-së është ofrimi dhe sigurimi i shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me politikat, strategjitë kombëtare dhe kurrikulën e arsimit parauniversitar, me qëllim zhvillimin dhe edukimin e plotë e të gjithanshëm të nxënësit, në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhmes.

Tabela më poshtë paraqet strukturën organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar;





Numri i miratuar i punonjesve në strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar është 509 punonjës.

II. RAPORTI I MONITORIMIT TË BUXHETIT TË DPAP-SË JANAR - DHJETOR 2023

Monitorimi i zbatimit të buxhetit në periudhën Janar- Dhjetor 2023 për Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, përfaqëson vlerësimin e performancës së fondeve buxhetore nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ato të planifikuar, duke i krahasuar me treguesit e vitit të mëparshëm.

Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të DPAP-së, të detajuara në nivel kategorie shpenzimi buxhetor kundrejt treguesve të planifikuar, duke mundësuar kështu sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar menaxhon fondet buxhetore të pagave, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative vetëm në programin buxhetor:

Planifikim Menaxhim

- **Baza ligjore për hartimin e kërkesave për financimin dhe realizimin e shërbimit arsimor publik, ku mbështeten kërkesat buxhetore për Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar:**
- Neni 57 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ”Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”.
- Vendimi nr. 195, datë 05.04.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmsëm 2024-2026”.
- Vendimit nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për arsimin 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.
- Vendimi nr. 90, datë 17.2.2021 Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (erp) 2021–2023”,
- Vendimi nr. 710, datë 1.12.2017 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022”.
- Vendimi nr. 99, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar”.
- Vendimi nr.175, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimitorë në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar”.
- Vendimi nr. 325, datë 31.5.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, i ndryshuar.
- Vendimi nr. 242, datë 20.4.2023 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendim nr.234, datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar,
- Vendimit nr. 113, datë 1.3.2023 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”,
- Vendimi nr. 77, datë 28.1.2015 të Këshillit të Ministrave “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” i ndryshuar.
- Vendimi nr. 682, datë 29.7.2015 të Këshilli të Ministrave “Për përdorimin e fondeve buxhetore për transportimin e mësuesve dhe të nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit”, i ndryshuar.

- *Vendimi nr. 870, datë 14.12.2011 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” i ndryshuar.*
- *Vendimi nr. 887, datë 27.12.2022 i Këshillit të Ministrave “Për Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike”.*

- **Politka e DPAP-së është hartuar për të kontribuar në realizimin e përgjegjësive:**

- ✚ Ofrimin e një shërbimi cilësor në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.
- ✚ Organizimin e punës për menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- ✚ Koordinimin e administrimit të burimeve njerëzore në sistemin arsimor parauniversitar publik, sipas legjislacionit në fuqi.
- ✚ Sigurimin se funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar për institucionet publike të arsimit parauniversitar të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- ✚ Vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të licënsimit dhe të ushtrimit të veprimtarisë së institucioneve arsimore private në fushën e arsimit parauniversitar, si dhe t’i propozojë ministrit dënimin administrativ plotësues të pezullimit apo heqjes së licëncës për ushtrimin e veprimtarisë.
- ✚ Vlerësimin nëpërmjet DRAP-ve dhe ZVAP-ve, kërkesat e ministrisë përgjegjëse për arsimin si dhe të shqyrtojë për përmbushjen e kriterëve infrastrukturore për hapjen e institucioneve arsimore dhe ushtrimin e veprimtarisë në fushën e arsimit parauniversitar.

- **Menaxhimi i buxhetit është fokusuar në financimin e shpenzimeve në funksion të përmbushjes së objektivave prioritare:**

- ✓ Të drejtojë dhe mbikqyrë procedurat e punësimit të mësuesve në institucionet e arsimit parauniversitar nëpërmjet Portalit “Mësues për Shqipërinë”;
- ✓ Të ndjekë procedurat për emërimin dhe shkarkimin e drejtuesve, mësuesve dhe personelit të institucioneve arsimore;
- ✓ Të verifikojë zbatimin e ligjshmërisë për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënëve në klasë;
- ✓ Të verifikojë regjistrimet e nxënësve, në ZVAP-et dhe institucionet arsimore publike dhe private;
- ✓ Të vlerësojë procesin e hartimit të planit afatmesëm dhe planit vjetor;
- ✓ Të vlerësojë planifikimin vjetor lëndor dhe planifikimin lëndor të periudhës bazuar në kurrikulën me kompetenca;

-
- ✓ Të monitorojë procesin e shpërndarjes së teksteve shkollore në ZVAP-et dhe institucionet arsimore publike;
 - ✓ Të monitorojë procesin e provimeve kombëtare në arsimin parauniversitar, sesioni i parë dhe i dytë;
 - ✓ Të koordinojë dhe monitorojë procesin e vlerësimit të arritjeve në arsimin fillor;
 - ✓ Të evidentojë fëmijët romë dhe egjiptianë dhe të monitorojë veprimtarinë e IA për këtë komunitet nxënësish.
 - ✓ Të monitorojë zbatimin e masave anti COVID -19 nga IA-të dhe zbatimin e udhëzimit të fillim vitit shkollor.
 - ✓ Të vlerësojë procesin e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë dhe mësuesve ndihmës;
 - ✓ Të koordinojë dhe monitorojë zhvillimin e rrjeteve profesionale në nivel ZVAP-i;
 - ✓ Të vlerësojë rolin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial në institucionet arsimore;
 - ✓ Të vlerësojë procesin e hartimit të Kartës së Performancës së shkollës në ZVAP-et dhe institucionet arsimore publike dhe private;
 - ✓ Të vlerësojë cilësinë e drejtimit dhe menaxhimit të IA-së. (fusha e I, vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i shkollës);
 - ✓ Të vlerësojë cilësinë e ofruar nga IA-ja për mirëqenien dhe sjelljen e nxënësve. (fusha IV, vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i shkollës)
 - ✓ Të vlerësojë procesin e zhvillimit të praktikave profesionale dhe të mentorimit të tyre.
 - ✓ Të menazhojë institucionin përmes planifikimit, monitorimit, raportimit me anë të planeve mujore, individuale, sektoriale dhe në nivel drejtorie;
 - ✓ Të informojë grupet e interesit me anë të raporteve të inspektimit, të raportit vjetor, si dhe të faqes së internetit, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
 - ✓ Të analizojë gjetjet nga inspektimet dhe monitorimet, të cilat do të shoqërohen me rekomandime për përmirësim dhe të bëjë sugjerime për ndryshime të nevojshme në bazën ligjore;
 - ✓ Të mirëmbajë faqen online të institucionit për përditësimin e informacioneve;
 - ✓ Të sigurojë se funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar për institucione publike të arsimit parauniversitar kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - ✓ Të vlerësojë përmbushjen e kriterëve të licensimit dhe të ushtrimit të veprimtarisë së institucioneve arsimore private në fushën e arsimit parauniversitar;
 - ✓ Të rakordojë me DRAP/ZVAP-et dhe institucionet arsimore publike për planifikimin dhe shpërndarjen e fondeve sipas parimit "Për nxënës";
 - ✓ Të mbështetet ASCAP nga DPAP dhe DRAP-et në mbledhjen e të dhënave për të ndërtuar bazën qendrore e të integruar të të dhënave të sistemit të arsimit parauniversitar;
 - ✓ Të vlerësohet nga DPAP dhe DRAP-et gjendja e mjedisit fizik/infrastruktura dhe mjaftueshmëria e burimeve, duke propozuar edhe masat e nevojshme;

- ✓ Të mbështetet ASCAP nga DPAP dhe DRAP-et në organizimin e procesit të identifikimit të nevojave për zhvillim profesional të të gjithë punonjësve të DRAP-ve dhe ZVAP-ve, specialistëve, drejtuesve, mësuesve etj;
- ✓ Të hartojë, sipas buxhetit të miratuar, planifikimin dhe zbatimin e planit financiar të prokurimit, konform akteve ligjore;
- ✓ Të menazhojë institucionin përmes planifikimit, monitorimit dhe raportimit me anë të planeve mujore, individuale, sektoriale dhe në nivel drejtorie;
- ✓ Të kryejë procedurat e prokurimit sipas procedurave ligjore dhe përdorimi i fondeve me efektivitet dhe efikasitet përgjatë vitit 2022;
- ✓ Të mirëmbajë faqen online të institucionit për përditësimin e informacioneve;
- ✓ Të zhvillojë ngritjen profesionale të stafit DPAP-së;
- ✓ Të përditësojë arshivën me aktet ligjore dhe nënligjore ne fuqi dhe ngritja e një arshive elektronike;
- ✓ Të trajtojë ankesat e mundshme;
 - a) DPAP-ja do të zgjidhë ankesat në fushën e arsimit parauniversitar që vijnë nga nxënës, mësues, prindër dhe qytetarë;
 - b) DPAP-ja, në bashkëpunim me DRAP-et dhe ZVAP-et , do të verifikojë ankesat e ardhura nga MAS dhe institucione të tjera.

III. ANALIZA E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË DPAP-SË JANAR - DHJETOR 2023

Për zbatimin e Buxhetit të periudhës Janar - Dhjetor 2023, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar ka vepruar në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr. 09, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, të ligjit nr.84/2022, “Për Buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimit plotësues nr. 02 datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”.


III.1 FONDET E MIRATUARA:

Buxheti i planifikuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar për vitin 2023 në programin buxhetor Planifikim Menaxhim (01110) në mijëra lekë paraqitet sipas tabelës:

Artikulli	Emërtimi	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor
		Plan Fillestar Viti 2023	Plan i Rishikuar Viti 2023
600	Paga	21,672	26,172
601	Sigurime Shogërore	3,619	4,232
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	5,500	5,500
603	Subvencione	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0
605	Transferta Korente të Huaja	0	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	100
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	30,791	36,004
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0
232	Transferta Kapitale	0	0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	0	0
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0
232	Transferta Kapitale	0	0

Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0
Totali	Shpenzime Kapitale	0	0
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti			
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		30,791	36,004

Pesha specifike sipas zërave të shpenzimeve, të planifikuara mbi totalin e shpenzimeve paraqitet sipas grafikut të mëposhtëm:



Siç shihet nga grafiku, zëri “Paga” zë 73% të buxhetit, zëri “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” zë 12 % të buxhetit, zëri “Mallra dhe Shërbime” zë 15% të buxhetit dhe zëri “transferime për buxhete familjarë dhe individë ” zë 1 % të buxhetit.

Në programin buxhetor “Nxënës përfitues të shërbimit arsimor në sistemin 9-vjeçar (Programi: 09120) Llogaria . Ekonomike: 602, fondi i rishikuar gjatë vitit është në shumën 3500 mijë lekë. për të bërë të mundur organizimin nga DPAP Tiranë të Olimpiadës Ballkanike të Matematikës për të rinj (JMBO) 2023.

Plan Buxheti për vitin 2023 për JMBO

Emërtimi Institucionit	Prog.	Llog. Ekonomike	Emërtimi i Produktit	Plan Fillestar	Plan i Rishikuar
DPAP	09120	602000	Nxënës përfitues të shërbimit arsimor në sistemin 9-vjeçar	5.000.0000	3,500,000

III. 2 REALIZIMI I SHPENZIMEVE SIPAS ZËRAVE PËR VITIN 2023

A- Shpenzime Personeli

Fondet e miratuara për shpenzime personeli për vitin 2023 përfshijnë fondet e miratuara për pagat dhe sigurimet shoqërore. DPAP mbulon shpenzimet e personelit vetëm për punonjësit e drejtorisë qendrore.

➤ Pagat e punonjësve. Llogaria 600

Fondi i miratuar nga buxheti i shtetit për vitin 2023 në zërin “paga” (600) është çelur në fillim të vitit në shumën 21,672,000 lekë. Me hyrjen në fuqi të *Vendimit nr. 325, datë 31.5.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, i ndryshuar. Vendimit nr. 242, datë 20.4.2023 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendim nr.234, datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar, Vendimit nr. 113, datë 1.3.2023 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” fondi i rishikuar për vitin 2023 në zërin Paga personeli është në shumën 26,172,000 lekë.*

Realizimi për periudhën janar- dhjetor 2023 është në shumën 25,375,794 lekë ose 97 % të planit vjetor.

➤ **Sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Llogaria 601**

Fondi i alokuar në fillim të vitit nga buxheti i shtetit për vitin 2023 në zërin; Sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601), është çelur në shumën 3,619,224 lekë. Plani i rishikuar për vitin 2023 me rritjen e pagave të punonjësve buxhetorë është në shumën 4,232,224 lekë.

Realizimi për periudhën janar- dhjetor 2023 është në shumën 4,176,829 lekë ose 99 % të planit vjetor.

Tatimin mbi të ardhurat dhe derdhja e kontributeve shoqërore janë bërë sipas përcaktimeve të ligjit Nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Vendimi nr. 604 datë 14.09.2022 të Këshilli të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”. Për periudhën janar – dhjetor 2023 janë likuaduar të gjitha detyrimet për sigurimet shoqërore dhe tatim taksat.

B- Shpenzime Operative

Fondet e miratuara për shpenzime operative për vitin 2023 përfshijnë fondet e miratuara për blerjen e mallrave dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për funksionimin e institucionit, pa përfshirë shpenzimet për DRAP dhe ZVAP.

➤ **Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera. Llogaria 602**

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2023 në zërin mallra e shërbime të tjera (llogaria 602) është çelur në shumën 5,500,000 lekë. Janë realizuar 4,857,385 lekë për periudhën janar-dhjetor 2023 ose 88 % të planit të periudhës vjetore.

Shpenzimet për këtë periudhë kryesisht janë fokusuar për mbulimin e shpenzimeve operative si drita, ujë, telefon, shërbim postar dhe udhëtim e dieta për punonjësit që janë dërguar me shërbim

jashtë qendrës së punës në funksion të monitorimit të veprimtarisë së institucioneve arsimor publike dhe jopublike.

Në shpenzimet operative të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar ka ndikuar dhe organizimi i aktivitetit të zbatimit të programit kombëtar “Arte, Zeje, Sport” jashtë orarit mësimor (JOM) në shumën 2,840,367 lekë. Aktivitet mbarëkombëtar i organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, katër Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe 52 Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar.

Efekti i rritjes së shpenzimeve operative në vitin 2023 vjen si rrjedhojë e organizimit të Olimpiadës Ballkanike të Matematikës për të rinj. Shpenzimet e transportit , akomodimit në hotel dhe ushqimit janë kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

Në vijim të shkresës së Drejtorisë së Politikave të Arsimit Parauniversitar në MAS “Për zhvillimin në Shqipëri të Olimpiadës Ballkanike të Matematikës për të rinj (JMBO) 2023”, për të bërë të mundur organizimin nga DPAP Tiranë të Olimpiadës Ballkanike të Matematikës për të rinj (JMBO) 2023, në muajin prill 2023 është bërë ndryshimi në shpërndarjen e fondeve buxhetore të vitit 2023 për Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar: *Programi: 09120 , Llog. Ekonomike: 602, Kod.Produkti: 91103AB, Emërtimi i Produktit: Nxënës përfitues të shërbimit arsimor në sistemin 9-vjeçar, Shtesë fondi: 5,000,000 lekë.*

Pas përfundimit të procedurave të prokurimit nga shuma totale 5,000,000 lekë , janë përdorur gjithsej 3,476,384 lekë nga të cilët 623,760 për shërbim transporti, 1,279,992 lekë për shërbim Bar-Restorant dhe 1,572,632 lekë për shërbim akomodimi në hotel.

Realizimi për vitin 2023 Për JMBO

Emërtimi Institucionit	Prog.	Llog. Ekonomike	Emërtimi i Produktit	Shuma lekë
DPAP	09120	602000	<i>Shpenzime Udhëtimi, Transport</i>	623,760
DPAP	09120	602000	<i>Shpenzime Shërbim Bar Restorant</i>	1,279,992
DPAP	09120	602000	<i>Shpenzime Shërbim Akomodim në Hotel</i>	1,572,632
DPAP	09120	602000	<i>Shpenzime Total JMBO</i>	3,476,384

➤ Vendimet gjyqësore.

Për vitin 2023 në fillim të vitit kishim planifikuar një shumë prej 680,000 lekë për ndonjë vendim gjyqësor që mund të dali gjatë vitit, por me ndryshimin e regjistrimit të prokurimeve publike të vitit 2023 , planifikimi për shpenzime gjyqësore është zero lekë.

➤ Transferta për buxhetet familjare dhe individët. Llogaria 606


Për periudhën janar-dhjetor të vitit 2022 janë realizuar 260,000 lekë për mbështetje financiare për punonjësit në zbatim të Në zbatim të VKM nr.898, datë 29.12.2022, “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësisë të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës”. Për periudhën janar- dhjetor 2023 kemi realizuar 100,000 lekë shpenzime për ndihma për sëmundje.

C- Shpenzime për investime kapitale. Llogaria 231.

Plani i buxhetit për vitin 2023 në investime kapitale është zero lekë. DPAP mbulon vetëm shpenzimet për institucionin, prandaj dhe nuk ka fonde në këtë zë të buxhetit. Në bazë të planifikimit të buxhetit dhe të rregullores për funksionimin e DPAP, janë Drejtoritë Rajonale të Arimit Parauniversitar që menaxhojnë fondet për shpenzime kapitale për institucionet e tyre dhe të varësisë.

Realizimi i shpenzimeve sipas zërave për vitin 2023, krahasuar me planin e vitit:


KODI	GR	PROG	KAP	PROJEKTI	ART	PLAN VJETOR	SHPENZIME THESARI	Në %
1011265	11	01110	1	91101AE	600	26,172,000	25,375,794	97%
1011265	11	01110	1	91101AE	601	4,232,224	4,176,829	99%
1011265	11	01110	1	91101AA	602	3,000,000	2,357,385	79%
1011265	11	01110	1	91101AD	602	2,500,000	2,500,000	100%
1011265	11	09120	1	91103AB	602	3,500,000	3,476,384	99%
1011265	11	01110	1	91101AE	606	100,000	100,000	100%
					Totali	39,504,224	37,986,392	96%



SITUACION I SHPENZIMEVE ME FONDE BUXHETORE per periudhen JANAR-Dhjetor 2023

leke

Art	Analiza		Fondet Buxhetore				Totali
	N/Art	Emërtimi	1110			9120	
			91101AE	91101AA	91101AD	91103AB	
		Numri i punonjesve(sipas programeve)					
		Plan	21	0	1		22
		<i>Fakt</i>	21	0	1		22
	2302000	Shpenzime për studime e kërkime	0				0
600		Plan	26,172,000	0	0		26,172,000
		<i>Fakt</i>	25,375,794	0	0		25,375,794
	6001001	P.Bazë	24,287,184	0			24,287,184
	6002002	Paga punto.Kontrat	1,071,393		0		1,071,393
	6003900		17,217				17,217
601		Plan	4,232,224	0	0		4,232,224
		<i>Fakt</i>	4,176,829	0	0		4,176,829
	6010100	Sig.shoq	3,742,970	0	0		3,742,970
	6011100	Sig.shënd.	433,859	0			433,859
602		Plan	0	3,000,000	2,500,000	3,500,000	9,000,000
		<i>Fakt</i>	0	2,357,385	2,500,000	3,476,384	8,333,769
	6020100	Kanceleri	0	132,000			132,000
	6022001	Elektricitet	0	284,164			284,164
	6022002	Uje	0	82,848			82,848
	6022003	Sherbime telefonike	0	30,000			30,000
	6022004	Posta dhe sherbimi korrier	0	156,170			156,170
	6022010	Sherbime te printimit dhe publikimit	0	114,000			114,000
	6024100	Udhetim i brendshem.	0	1,202,836		623,760	1,826,596
	6026100	Shpenzime qeraje	0	355,367	2,485,000		2,840,367
	6029001	Shpenzime per pritje e percjellje.	0	0	0	2,852,624	2,852,624
	6029008	Shpenzime taksa vendore te paguara nga institucioni	0	0	15,000		15,000
606		Plan	100,000	0	0		100,000
		<i>Fakt</i>	100,000	0	0		100,000
	606000	shperblim per semundje	100,000	0			100,000
		Plan	30,504,224	3,000,000	2,500,000	3,500,000	39,504,224
Totali		<i>Fakt</i>	29,652,623	2,357,385	2,500,000	3,476,384	37,986,392



D. Mbi raportimin e detyrimeve të prapambetura të akumuluarra dhe krijuara rishtazi për vitin 2023.

Në zbatim të ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, vendimit nr.50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, si dhe të udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014, të Ministrit të Financave “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Shtojca 3, detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi dhe akumuluarra për vitin 2022 dhe për periudhën Janar-Dhjetor 2023 janë zero lekë.

Për sa më sipër në periudhën janar- dhjetor 2023 në DPAP nuk është krijuar asnjë detyrim dhe nuk ka detyrime të prapambetura nga vitet e kaluara.

E. Numri i punonjësve 2023

Numri i miratuar i punonjësve në këto struktura është 509 punonjës, ndërsa numri faktik i punonjësve është 487 punonjës, nga të cilët 342 janë femra, pra 70% e tyre.



Numri i punonjësve vetëm në drejtorinë qendrore DPAP

Emërtimi	Punonjës të planifikuar	Punonjës fakt	Punonjës me kontratë
Numri	21	21	1

Praktikat e punës në administratën shtetërore.

Në zbatim të VKM nr 395, datë 29.04.2015, “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucione të tjera publike”, të ndryshuar, si dhe në mbështetje të shkresës së MFE nr 277/1, datë 18.01.2022 “Detajimi i numrit të studentëve praktikantë për vitin 2023”, për periudhën Janar 2023–Janar 2024, është planifikuar 1 specialist.

F. Prokurimet Publike

Referuar Regjistrin të Realizimit të Prokurimeve Publike për periudhën Janar-Dhjetor 2023 janë realizuar:

➤ *Blereje me Vlerë të Vogël:*

- Kancelari
- Shërbim transport pjesëmarrësit në olimpiadën Ballkanike të Matematikës për të rinj.
- Shërbime Printimi
- Shërbim, akomodim, ushqim për pjesëmarrësi t e olimpiadës Ballkanike të Matematikës për të rinj
- Qera Ambienti per Aktivitetin "Arte dhe Zeje"

IV. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

IV.1. Të dhëna mbi numrin e institucioneve arsimore për vitin shkollor 2021-2022 dhe 2022-2023

Në vitin shkollor 2021-2022 numri i institucioneve arsimore ishte si më poshtë:

Kopshte Gjithsej		Totali Kopshte	Shkolla Publike (Drejtori më Vete)		Totali Shkolla Publike	Shkolla Private (Drejtori më vete)		Totali Shkolla Private
Publike	Private		9-vjeçare + SHMB	Gjinnaze + të mesme të orientuara		9-vjeçare	Të mesme	
1,847	243	2090	1051	347	1,398	115	105	220


Në këtë vit shkollor në arsimin publik ishin 197 shkolla të mesme të bashkuara dhe 875 shkolla vartëse

Në vitin shkollor 2022-2023 numri i institucioneve arsimore është si më poshtë:

Kopshte Gjithsej		Totali Kopshte	Shkolla Publike (Qendër)		Totali Shkolla Publike	Shkolla Private		Totali Shkolla Private
Publike	Private		9-vjeçare + SHMB	Gjinnaze+ të mesme të bashkuara		9-vjeçare	Të mesme	

1, 840	227	2067	1029	349	1378	112	102	214
--------	-----	------	------	-----	------	-----	-----	-----

Për vitin shkollor 2022-2023 janë 197 shkolla të mesme të bashkuara dhe 837 shkolla vartëse.



Numri i nxënësve që mësojnë në shkollat e mesme të bashkuara, për vitin shkollor 2022-2023 është 37458 nxënës, përkatësisht: 24816 nxënës në arsimin bazë dhe 12642 nxënës në arsimin e mesëm të lartë.

Numri i nxënësve për vitin shkollor 2021-2022

Në Kopshte gjithsej		Total fëmijë në kopshte	Numri i nxënësve në Shkolla Publike (drejtori më vete)		Totali në shkolla publike	Numri i nxënësve në Shkolla Private		Totali në shkolla private
Publik	Privat		9-vjecare	Gjimnaze + mesme të orientuara te Veçanta		9-vjecare	Mesme	
62,104	10,280	72,384	251,207	73,042	324,249	26,931	12,146	39,177

Numri i nxënësve për vitin shkollor 2022-2023

Në Kopshte gjithsej		Total fëmijë në kopshte	Numri i nxënësve në Shkolla Publike (drejtori më vete)		Totali në shkolla publike	Numri i nxënësve në Shkolla Private		Totali në shkolla private
Publik	Privat		9-vjecare	Gjimnaze + mesme të orientuara te Veçanta		9-vjecare	Mesme	
60,008	9,742	69,750	23,8997	6,6999	305,996	28,278	12,033	40,311

IV.2. Të dhëna për numrin e punonjësve mësimorë, për vitin shkollor; 2023-2024.

Në zbatim të VKM-së, nr.99, datë 27.02.2019, “Për Krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Kreu III, pika 7, “*Struktura dhe organika e zyrave vendore të arsimit miratohen më urdhër të ministrit, ndërsa organika e institucioneve të arsimit parauniversitar publik miratohet nga drejtoria rajonale, sipas propozimeve të secilës zyrë vendore të arsimit, brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve të miratuar nga ministria për secilën zyrë vendore arsimore*”,

Numri i miratuar i punonjësve për vitin shkollor 2023-2024

Numri i miratuar i punonjësve mësimor në AMU (09120)	23675	30156
Numri i miratuar i punonjësve mësimor në AML (09230)	6481	

IV.3. Të dhëna për punësimet


Punësime nga Portali dhe jashtë Portalit për peridhen Janar- Dhjetor 2023

Bazuar në Udhëzimin Nr.12 dt 10.06.2021 të MASR “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe per administrimin e Portalit “Mesues per Shqiperine”, Udhëzimin Nr.14, datë 10.07.2023 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar, DRAP monitorojnë dhe dërgojnë informacion mbi punësimet nga portali “Mësues për Shqipërinë” me kontratë të përkohëshme, me kontratë të përherëshme, si edhe punësimet jashtë portalit.

Referuar këtyre raportimeve, më poshtë pasqyrojmë punësimet sipas DRAP dhe sipas profileve:

Punësimet per periudhen Janar - Dhjetor 2023

NR		Punësime vende definitive nga portali	Punësime vende provizore nga portali	Punësime me kandidatë jashtë portalit	Gjithsej punësime
1	DURRES	474	1343	652	2469
2	FIER	156	665	176	997
3	KORÇË	154	816	179	1149
4	LEZHË	99	438	469	1006
	TOTALI	883	3262	1476	5621



Punësimet të shprehura sipas profilit:

NR	PROFILI	Vende definitive dhe provizore		Punësi me vende definitive nga portali	Punësime vende provizore nga portali	Punësime me kandidatë jashtë portalit	Gjithsej punësime
		Vende definitive të deklaruar	Vende provizore të deklaruar				
1	Arsimi Fillor	350	668	153	331	485	969
2	Arsimi Parashkollor	3	7	0	6	5	11
3	Arsimi Special	435	1065.5	203	1178	98	1479
4	Art Pamor	18	67	5	35	45	85
5	Art pamor (shkolla artistike)	4	3	3	3	1	7
6	Balet (shkolla artistike)	2	1	0	0	2	2
7	Biologji	35	159.5	28	125	41	194
8	Edukim Fizik	167	283	97	198	142	437
9	Fizikë	43	111	28	73	42	143
10	Gjeografi	15	84	14	71	12	97
11	Gjuhë Angleze	174	427	121	310	167	598
12	Gjuhë Frënge	18	83	16	52	27	95
13	Gjuhë Gjermane	2	16	2	10	4	16
14	Gjuhë Greke	2	3	1	0	4	5
15	Gjuhë Italiane	11	74	10	61	12	83
16	Gjuhë Maqedonëse	0	0	0	0	0	0
17	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	45	260	26	212	54	292
18	Histori	26	156	20	136	22	178
19	Kimi	10	51	9	38	7	54
20	Matematikë	135	344	74	208	185	467
21	Muzikë	19	79	9	43	42	94
22	Muzikë (shkolla artistike)	32	56	13	31	28	72
23	Shkenca Sociale	15	66	12	58	9	79
24	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	68	99	39	83	39	161
25	Turqisht	0	2	0	0	2	2
25	Spanjisht	0	1	0	0	1	1
	TOTALI	1629	4166	883	3262	1476	5621


Punësime nga Portali Janar – Dhjetor 2023 (Kontrate me dhe pa afat)

NR	DRAP	Punësime me kontrate pa afat nga portali	Punësime me kontrate me afat nga portali	Gjithsej punësime nga Portali
1	DURRES	474	1343	1817
2	FIER	156	665	821
3	KORÇË	154	816	970
4	LEZHË	99	438	537
	TOTALI	883	3262	4145

Oficerët e Sigurisë:

Në zbatim të Vendimit Nr. 600, datë 9.10.2018, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e shërbimit të sigurisë”, të ndryshuar, urdhrat të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për përcaktimin e institucioneve të arsimit parauniversitar të cilat do të kenë oficerë sigurie” dhe shkresës me Nr.98/2.Prot. datë 20.01.2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për punësimin e oficerëve të sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar publik”, situata paraqitet si më poshtë:

Nr.	DRAP	Numri i OS te miratuar ishte	Numri i OS pas ndryshimit
1	Durrës	61	113
2	Fier	23	37
3	Korçë	42	43
4	Lezhë	24	29
	Totali	150	222

**IV.4. Informacion për numrin e nxënësve me aftësi të kufizuar dhe mësuesit ndihmës për vitin shkollor 2022-2023.**

Në politikën e Ministrisë së Arsimit, dhe Sportit objektiv kryesor është rritja e përfshirjes të fëmijëve me aftësi të kufizuar në sistemin e arsimit parauniversitar. Në sistemin e arsimit parauniversitar nxënësit me aftësi të kufizuara frekuentojnë shkollat normale dhe shkollat

speciale. Referuat të dhënave statistikore të regjistrimeve për vitin shkollor 2022-2023, janë 4207 nxënës me aftësi të kufizuar nga të cilët 4118 janë në arsimin publik dhe 89 nxënës janë në arsimin privat. Krahasuar me numrin total të nxënësve për këtë vit shkollor, i cili është 346 307 nxënës, kjo kategori përbën 1.2% të nxënësve. Nga 4207 nxënës me aftësi të kufizuara, 3571 janë nxënës me aftësi të kufizuara mendore dhe 636 nxënës janë me aftësi të kufizuara fizike.

Nga 4207 nxënës me aftësi të kufizuara, 3707 prej tyre frekuentojnë shkolla normale dhe vetëm 573 prej tyre janë në shkolla speciale.

Për vitin shkollor 2022-2023 janë 1776 mësues ndihmës në arsimin publik

Më poshtë pasqyrojmë të detajuar numrin e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin publik (arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë) në nivel Drejtorie Rajonale:

Arsimi Publik (AB+AML)

Nr.	DRAP	Nxënës Gjithsej (AB+AML)	Total nxënës me AK	Totali Mësues Ndhmës	Raporti Nxënës me AK/mësues Ndhmës
1	Durrës	142751	1714	648	2.6
2	Fier	52541	856	475	1.8
3	Korçë	67020	976	383	2.5
4	Lezhë	43684	572	270	2.1
	Totali	305996	4118	1776	2.3

IV.5. “SHËRBIMI PSIKOSOCIAL” 2023

Bazuar në Udhrrin Nr. 461, datë 27.07.2022 për një ndryshim në Urdhrrin Nr. 313, datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social” është bërë dhe riorganizimi i këtij shërbimi, duke rritur përsëri numrin e punonjësve në institucionet arsimore në vend, sipas specifikimeve përkatëse:

- një psikolog/punonjës socialë për 300– 499 nxënës,
- dy psikolog/punonjës socialë për çdo shkollë me 500 ose më shumë nxënës,
- një psikolog/punonjës socialë për çdo shkollë që ka të paktën 8 nxënës me AK të përcaktuar me raport të Komisionit Mjeko-Ligjor,
- në rastet kur shkollat janë me numër të vogël nxënësish, një psikolog/punonjës social do të mbulojë disa shkolla dhe numri i nxënësve do të jetë nga 80-299.

Aktualisht në sistemin arsimor parauniversitar janë të punësuar 747 punonjës të shërbimit psiko-social nga 614 punonjës të punësuar në vitin shkollor 2022-2023.

Më konkretisht, tabela krahasuese:

DRAP	Psikolog		Punonjës Social	
	2021-2022	2022-2023	2021-2022	2022-2023
DURRËS	196	215	85	101
FIER	61	70	37	48
KORÇË	80	96	63	91
LEZHË	67	88	25	38
GJITHSEJ	404	469	210	278

IV.6 . VEPRIMTARI MONITORUESE INSPEKTUESE DHE VLERËSUESE.

DPAP ka zhvilluar veprimtarinë e saj, duke zbatuar planin vjetor mbështetur në prioritetet e MAS me veprimtari, të tilla si:

- Monitorimi i shkollës për zbatimin e nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë” (6 IAP)
- Monitorimi i shkollës për zbatimin e nismës “Shkolla Qendër Komunitare” (3 ZVAP)
- Monitorimi i ZVAP-së për procedurat e ndjekura për kualifikimin e mësuesve 2023 (3 ZVAP)
- Monitorimi i IAP-ve për masat e marra për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore (6 IAP)
- Monitorimi i Zyrove Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP), për masat e marra për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.(21 ZVAP)
- Monitorim i IAP parashkollore private për zbatimin e kriterëve të ligjshmërisë (31 IAP private)
- Monitorimin e IAP-ve për marrjen e masave për MSH dhe PKAB 2023 (18 IAP)
- Monitorimi i IAP-ve për cilësinë e procesit mësimor në funksion të arsimimit të nxënësve me AK me qëllim integrimin dhe gjithëpërfshirjen e tyre (88 IAP)
- Vlerësimin e IAP-ve për marrjen e masave për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale, si dhe për procedurat e vlerësimit të praktikantëve (8 IAP)
- Vlerësim i IAP privat Medrese për verifikim ankese.(1 IAP)
- Vlerësimi i Zyrove Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP), për masat e marra për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. (3 ZVAP)
- Vlerësim i IA parashkollor privat Bim Bam Bum për verifikim ankese.(1 IAP privat)
- Vlerësim i DRAP për procedurat e ndjekura për Portalin Mësues për Shqipërinë. (2 DRAP)
- Vlerësim i Zyrove Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP), për zbatimin e procedurave të lëvizjes paralele (detyruar/ me dëshirë) dhe procedurave të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune (22 ZVAP)
- Vlerësim i IAP publik "Jordan Misja" , Tiranë për verifikim ankese.(1 IPAP)

- Vlerësim i IAP publik "Kongresi i Lushnjes", Tiranë për verifikim ankese. (1 IPAP)
- Vlerësim i IA parashkollor privat "Lulet e Jetës", Shijak për verifikim ankese. (1 IAP)
- Vlerësim i IAP publik "Emin Duraku", Tiranë për verifikim ankese.(1 IPAP)
- Inspektim i IAP parashkollor private për zbatimin e kritereve të ligjshmërisë (60)
- Vlerësim i IAP publik "Gjon Buzuku", Tiranë për verifikim ankese.
- Vlerësim i IAP publik "Ardian Klosi", Tiranë për verifikim ankese.
- Vlerësimi i IAP-së për cilësinë e hartimit dhe zbatimit të planit vjetor lëndor dhe të periudhës së dytë. (6)
- Vlerësimi i IAP për fushën "Drejtimi dhe menaxhimi. (7)
- Vlerësim i shkolles për zbatimin e kurrikulës së lëndës TIK në klasën e parë për ecurinë e Projektit Element It (22)
- Janë trajtuar rreth 59 ankesa mbi problematikat e ndryshme në DPAP duke kthyer përgjigje zyrtare brenda afateve të përcaktuara në ligj

IV.7. KURRIKULA DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Objektiva aktivitetet dhe nismat kryesore të sektorit të kurrikulës, monitorimit dhe zhvillimit profesional

- **KLASA TË PROFILIZUARA NË SPORT, VITI SHKOLLOR 2023-2024.**

Në zbatim të Urdhrit Nr.31, dt.28.01.2020, "Për miratimin e rregullores për funksionimin e IAP në RSH", kreu 3 neni 11 për hapjen e klasave të profilizuara në sport si dhe të Udhëzimit të përbashkët Nr.15, datë 24.07.2023 për "Vitin shkollor 2023-2024 në Sistemin Arsimit Parauniversitar". neni 16 për zbatimin e marrëveshjeve dhe memorandumeve, në institucionet e arsimit parauniversitar, për këtë vit shkollor janë hapur gjithsej 228 klasa sportive në tre disiplina, futboll, volejboll dhe basketboll.

DRAP	KLASA SPORTIVE FUTBOLL	KLASA SPORTIVE BASKETBOLL	KLASA SPORTIVE VOLEJBOLL	TOTAL KLASA SPORTIVE
DURRËS	78	5	52	135
FIER	5	4	1	10
KORCË	6	8	14	28
LEZHË	26	1	28	55
TOTAL	115	18	95	228

VLERËSIMI I PROGRAMIT MËSIMOR TË GJUHËS ANGLEZE PËR KLASAT I-V NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR:

Raporti për vlerësimin e programeve të gjuhës angleze klasa I-II dhe të programeve lëndorë të gjuhës së huaj të parë klasa III-V u hartua nga grupi i punës me përfaqësues të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit

Parauniversitar (DPAP), Zyrës Vendimore Arsimore Tiranë (ZVAT) në bashkëpunim me mësues të gjuhës angleze në Arsimin Fillor (AF) dhe Arsimin e Mesëm të Ulët (AMU).”

➤ **ZHVILLIMI I OLIMPIADAVE KOMBËTARE NË ARSIMIN
PARAUNIVERSITAR PËR VITIN SHKOLLOR 2022 - 2023**

Në zbatim të Urdhrit nr. 24, datë 23.01.2020, “Per miratimin e rregullores për zhvillimin e olimpiadave kombëtare në arsimin parauniversitar dhe pjesëmarrjen e nxënësve në olimpiadat ndërkombëtare”, dhe Urdhrit nr. 655, datë 04.11.2022, “ Për përcaktimin e datave të zhvillimit të olimpiadave kombëtare në arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë, për vitin shkollor 2022-2023 ”, u organizuan dhe u zhvilluan në tre faza olimpiadat kombëtare për vitin shkollor 2022-2023 përkatësisht në lëndët: matematikë AMU, matematikë AML, Fizikë AML, Kimi AML, Biologji AML, Informatikë AML, Gjuhë Shqipe dhe Letërsi AML, Histori AML dhe Gjeografi AML. Faza e parë u zhvillua në nivel institucioni arsimor, faza e dytë u zhvillua në nivel ZVAP-i dhe faza e tretë u zhvillua në nivel kombëtar.

Faza e tretë në nivel kombëtar

	Të ndarë sipas vendit dhe klasave	FITUES	KLASA 9	KLASA 10	KLASA 11	KLASA 12
1	Nxënës fitues të vendit të parë	7	1	0	3	3
2	Nxënës fitues të vendit të dytë	9		2	3	4
3	Nxënës fitues të vendit të tretë	39		6	17	16
	GJITHSEJ	55	1	8	23	23

MONITORIMI I ZHVILLIMIT TË JBMO 2023 –

Junior Balkan Mathematical Olympiad 2023-Olimpiada Ballkanike e Matematikës për të Rinj 2023.

Olimpiada Ballkanike e Matematikës për të Rinj JBMO Albania 2023, u zhvillua në Shqipëri nga data 23.06.2023- 28.06.2023, nga Shoqata Shqiptare e Matematikës në koordinim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar. Në këtë aktivitet morën pjesë gjithsej 19 ekipe nga të cilat 10 ekipe zyrtare dhe 9 ekipe mike. Në JBMO morën pjesë zyrtarisht nxënës deri në moshën 15 vjeç. Ekipet ishin të përbërë prej 6 konkurrentësh , 2 shoqëruesit (leader & deputy leader) dhe persona të tjerë shoqërues (të afërm ose miq, të cilët hyjnë në kategorinë e vëzhguesve): morën pjesë 106 nxënës, 27 shoqërues/vëzhgues, të cilët u akomoduan në Hotel “Continental Group” sha për 5 netë (fjetje dhe ushqim-3 vakte). Pjesëmarrës në olimpiadë ishin dhe 32 lidera, të cilët u akomoduan në Hotel “Eurostar Tirana”, Tiranë.

➤ **SISTEMI I MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT PARAUNIVERSITAR- SMIP**

Sistemi i menaxhimit të informacionit parauniversitar (SMIP) në cilësinë e një projekti të nisur tashmë nga qeveria shqiptare, lidhet drejtpërdrejt me përmirësimin e sistemit arsimor duke

mbledhur dhe përpunuar të gjithë informacionin e arsimit parauniversitar, duke rritur nivelin e interaktivitetit digjital të shkollave si dhe duke inkurajuar përdoruesit të përdorin teknologjitë e reja në arsim brenda sistemit. Projekti shtrihet në sistemin e arsimit parauniversitar në kuptim të ligjit 69/2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”. Aplikacioni mobile edhe për mësuesit lehtëson qasjen e sistemit arsimor në sistem nëpërmjet pajisjeve smart phone gjatë punës së përditshme të përditësimit në kohë reale të të dhënave të sistemit. Ai është dizenuar duke patur parasysh qasjen e përdoruesit, duke lejuar këdo, pavarësisht nga niveli i tij i aftësive digjitale, të ketë qasje në funksionalitetet kryesore të sistemit SMIP përmes një ndërfaqe të adaptueshme dhe intuitive. Përmes aplikacionit, mësuesi ka mundësi të hedhi notat dhe mungesat si dhe të zhvillojë mësimin online. Prindërit/kujdestarët ligjorë mund të ndjekin progresin e përgjithshëm të fëmijëve të tyre si dhe vlerësimet e çdo lënde, komente të ndryshme nga mësuesit, mungesat etj. Gjithashtu prindi njoftohet me e mail apo sms për çdo notë të marrë nga fëmijët apo mungesë të tyre. SMIP është ndërtuar me koordinatort Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), i cili realizohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QShA).

PAJISJA E 200 SHKOLLAVE ME SMARTLAB

MAS do të udhëheqë aktivitetet në komponentin “SmartLabs” nga këndvështrimi arsimor, duke përfshirë zhvillimin dhe vendosjen e përmbajtjeve mësimore, ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimin e mësuesve, drejtorëve dhe përmirësimin e kurrikulës, si dhe sigurimin e të dhënave për sistemin e monitorimit të të mësuarit dhe llogaridhënies. AKSHI do të fokusohet në aspektet infrastrukturore të TIK-ut të SmartLabs.

Në këtë fazë të projektit që jemi DPAP në bashkëpunim me MAS ka mundësuar:

Përzgjedhjen e 200 shkollave që do të bëhen pjesë e projektit (minimalisht është përfshirë një shkollë me klasa kolektive dhe një shkollë në të cilën ka nxënës të komunitetit rom).

FUNKSIONIMI I NISMËS “SHKOLLA SI QENDËR KOMUNITARE”.

Legjislacioni aktual për arsimin, mbështet funksionimin e një shkolle të hapur për vendimmarrje të përbashkët me familjen dhe komunitetin

- Në kuadër të SHQK, janë zhvilluar 14983 eprimtari sipas llojeve
 1. Veprimtari për zhvillimin akademik të nxënësve-4622
 2. Veprimtari për zhvillimin artistik, kulturor dhe sportiv-5515
 3. Veprimtari për angazhimin dhe mbështetjen e familjes-2025
 4. Veprimtari për angazhimin e komunitetit-2821

- **Të ndarë sipas llojit të shkollës dhe zonës ku ndodhen kemi situatën e mëposhtme:**

LLOJI SHKOLLËS	SHKOLLA SHQK
AML	122
AMU	312
AF	1
SHMB	87
Total	522

ZONA KU NDODHET SHKOLLA	SHKOLLA SHQK
FSHAT	263
QYTET	259
Total	522

NISMA “BËJMË DETYRAT E SHTËPISË”

Në zbatim të Urdhrit nr.811, datë 14.12.2018 “Për miratimin e udhëzuesit për zbatimin e nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, në vitin shkollor 2023-2024, nisma “Bëjmë detyrat e shtëpisë” po zbatohet në 188 institucione Arsimore, janë formuar 444 klasa mësimore, në të cilat janë përfshirë 8575 nxënës dhe 1671 mësues.

ZBATIMI I PROGRAMIT KOMBËTAR “ART, ZEJE, SPORT” JASHTË ORARIT MËSIMOR (JOM)

Programi Kombëtar “Art, zeje, Sport” i quajtur ndryshe dhe si Programet Jashtë Orarit Mësimor (JOM) po zbatohet në sistemin arsimor parauniversitar në 200 Shkolla Qendër Komunitare të zgjedhura nga ZVAP-të dhe miratuara nga MAS.

DRAP	Programi JOM/DRAP
Durrës	49
Fier	44
Korçë	60
Lezhë	47
	200

Kurset kryesore janë : Pikturë; Vegla muzikore; Bujqësi, mjedisi ; Zeje; Kor; Teatër; Sport-Fuqizim për vetmbrojtje; Teknologjia

V. BASHKËPUNIME INSTITUCIONALE

Gjatë vitit 2023 DPAP-ja ka bashkëpunuar me institucionet MAS, ASCAP, DRAP dhe ZVAP duke u angazhuar maksimalisht me propozime konkrete për ndryshimin e bazës ligjore në fuqi duke u mbështetur në problematikat dhe vështirësitë që janë hasur gjatë zbatimit në praktikë të tyre. Më poshtë paraqesim shkurtimisht disa nga ndryshimet e propozura;

- Rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë.
- Draft strategjinë 2021-2026 MASR,
- Propozuar për ndryshim Udhëzimi nr.12, datë 10.06.2021 “Për pranimin dhe emërimin në një vend të mirë pune të mësuesit në institucionet arsimore parauniversitare nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”. Qëllimi i këtyre propozimeve lidhet me rritjen e efektivitetit dhe zbatimit të procesit të pranimit/emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune. Nëpërmjet propozimeve është synuar të:
 - Ndryshohet përgjegjësia për procedurat e konkurrimit dhe të pranimit të mësuesit në një vend të lirë punë.
 - Të qartësohet përgjegjësia dhe kompetencat ndërmjet institucionit epror dhe atij vartës.
 - Implementimin e konceptit të kandidatëve të arsimit parashkollor.
 - Shpallja e vendit të lirë të punës të bëhet mbi bazën e ndarjes së nivelit të diplomës.

Përcaktimi i të drejtave të drejtorit të institucionit arsimor parauniversitar mbi shkeljet e profesionit të mësuesit.

- Udhëzimin Nr.2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”.
- Vlerësimin e Kartës së performancës së shkollës,
- Standardet profesionale të vlerësuesit të institucioneve të arsimit parauniversitar,
- Urdhërit nr.313, datë 20.10.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social.
- Për disa ndryshime në urdhërin nr.234, datë 19.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar”
- Draft rregulloren e Maturës Shtetërore dhe Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë.
- Amzën digjitale apo mënyrën e regjistrimit të nxënësve në klasën e parë dhe të dhjetë të arsimit bazë.
- Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.
- Për disa ndryshime në VKM nr. 682, datë 29.07.2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, të ndryshuar.
- Kërkesë për ndryshimin e Urdhrit nr.454, datë 13.09.2019 “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj”.
- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar në bashkëpunim me Agjensinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, kanë nënshkruar një “Marrëveshje Bashkëpunimi”. Për realizimin e kësaj marrëveshje janë impenjuar që të dyja institucionet për të hartuar një marrëveshje konform parimeve ligjore dhe mbrojtjes së të drejtave dhe detyrimeve për të dyja palët. Bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta gjatë gjithë vitit shkollor, për një orientim më të mirë të nxënësve të institucioneve të arsimit të mesëm të ulët drejt Arsimit Profesional si dhe në përgjigje të kërkesave të punësimit për t’i garantuar dhe ofruar tregut, individ të arsimuar nga shkolla profesionale të cilët do të jenë profesionist në fusha përkatëse duke rritur efikasitetin dhe efektivitetin e punësimeve, parë kjo në aspekt afatgjatë.

VI. PËRFUNDIME

Për periudhën Janar-Dhjetor 2023, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar ka zbatuar politikën menaxheriale duke u fokusuar në nevojat e domosdoshme dhe duke u përqëndruar në përgjegjësitë funksionale të saj, të cilat konsistojnë në:

1. Ofrimin e një shërbimi cilësor në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.
2. Organizimin e punës për menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të sistemit

Arsimor parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Koordinimin e administrimit të burimeve njerëzore në sistemin arsimor parauniversitar sipas legjislationit në fuqi.etj.

Në veprimtarinë e saj të përditshme nisur dhe nga problematikat që hasen në zbatim, ka lindur nevoja për ndryshime të bazës nën ligjore në fuqi të cilat i listojmë më poshtë.

- ✓ Udhëzimi Nr.12 dt 10.06.2021 të MASR “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit. parauniversitar dhe per administrimin e Portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar.
- ✓ Udhëzimi Nr 30 datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve në klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
- ✓ Vendimi nr. 682, datë 29.7.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, i ndryshuar.
- ✓ Rregullore nr.4699/1 datë 30.04.2019 ”Për rekrutimin e punonjësve në varësi të DPAP-së”
- ✓ Urdhri i Ministrit të MASR Nr. 31 datë 28.01.2020 “Për miratimin e Rregullores për funksionimin e Institucioneve të Arsimit Parauniversitar”.
- ✓ Udhëzimi Nr.2 datë 28.01.2020, për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të IPAP, të ndryshuar"